Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORT FINAL I AUDITIMIT PËR MINISTRINË E FINANCAVE

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Financave, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Blerina Krasniqi (udhëheqës ekipi), Ariana Berisha-Rexhëbeqaj dhe Leonora Hasani (anëtare ekipi) nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Blerim Kabashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme....4

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit....6

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm....7

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli....9

4 Qeverisja e mirë....18

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve....21

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA....26

Shtojca II: Komentet e MF-së në gjetjet e raportit të auditimit....29

Përmbledhje e përgjithshme

Ky Raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Financave për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit për vitin 2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Financave.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale. Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Procesi i përgatitjes së PFV-ve është menaxhuar në pajtim me legjislacionin në fuqi.	Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.
Planifikimi dhe realizimi i buxhetit në kategorinë mallra dhe shërbime dhe komunali nuk është në nivelin e kënaqshëm.	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për të arritur një performancën me të mirë buxhetore në nivel të kategorive ekonomike. (shih çështjen B1).
Edhe pse kontrollet e brendshme kanë operuar në mënyrë efektive në disa fusha, dobësi evidente janë vërejtur në sisteme të rëndësishme financiare, duke përfshirë prokurimin, personelin dhe menaxhimin e pasurisë.	Ministri duhet të përmirësoj/forcoj kontrollet në proceset ku janë evidentuar dobësi/dështime, si në prokurim, menaxhimin e personelit, si dhe menaxhimin e pasurisë (shih çështjet A1 dhe B2).
Përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak nuk po adresohet në masën e duhur për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.	Ministri duhet të siguroj që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve realizohet në mënyrë aktive dhe çështjet e adresuara i raportohen menaxhmentit në baza të rregullta (shih kapitullin 5)
Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial janë të mira, por komiteti i auditimit duhet të jetë më aktiv në trajtimin e çështjeve të auditimit.	Ministri duhet të sugjeroj çështjet me prioritet për t'u trajtuar nga KA, në mënyrë që të sigurohet se roli dhe misioni i të njëjtit po përmbushet (shih çështjen A2).

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Ministri është pajtuar me të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi i kryer nga ana jonë përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë së Financave, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

1. Opinion i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Financave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga Ministria e Financave kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 Për Shpenzimin Parave Publike dhe Rregullën Financiare nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare;
- Kërkesat e Ligjit Nr. 06/L- 020 për Buxhetin Republikës Kosovës për vitin 2018;
- Planin e Veprimit për Adresimin e Rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Draft Plani dhe Plani Përfundimtar i Prokurimit.

Lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I MINISTRISË SË FINANCAVE

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve, mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë, pasi që gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Fusha e prokurimit vazhdon të përcillet me probleme, duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur për para. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit, procesi i prokurimit, personeli dhe menaxhimi i pasurisë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[1]	Realizimi 2018	Realizimi 2017	Realizimi 2016
Burimet e Fondeve	**35,192,284**	**31,617,966**	**27,351,666**	**23,125,136**	**21,936,786**
Granti i Qeverisë - Buxheti	35,192,284	31,106,501	26,958,879	22,813,721	21,479,420
Financim nga huamarrja	0	0	0	0	87,935
Donacionet e jashtme	0	511,465	392,787	311,415	369,431

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 3,574,318€. Ky zvogëlim kishte ndodhur me vendim të Qeverisë si rezultat i shkurtimeve/kursimeve.

Në vitin 2018, MF së bashku me agjencitë e saj ekzekutive (Doganën dhe Administratën Tatimore të Kosovës) ka shpenzuar 87% të buxhetit final ose 27,351,666€, me një rritje 2% krahasuar me vitin 2017. Nëse përjashtojmë mjetet për Fondin Zhvillimor të Mirëbesimit në vlerë prej 1,858,258€ i cili nuk menaxhohet nga MF, atëherë realizimi i buxhetit final është 92%, që krahasuar më vitin e kaluar ka një ulje prej 3%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	**35,192,284**	**31,617,966**	**27,351,667**	**23,125,136**	**21,936,786**
Pagat dhe Mëditjet	15,016,572	16,294,982	16,165,796	15,034,273	15,023,227
Mallrat dhe Shërbimet	6,596,366	6,668,571	5,466,262	5,004,579	5,311,572
Shërbimet komunale	488,592	375,471	306,571	311,315	316,892
Subvencionet dhe Transferet	3,226,000	3,305,432	2,722,291	1,241,086	288,757
Investimet Kapitale	9,864,754	4,973,510	2,690,747	1,533,883	996,338

[1] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Në tabelën në vijim dhe më tutje në raport, do të paraqesim buxhetin dhe shpenzimet e ministrisë, duke përjashtuar të dhënat për Doganën dhe ATK-në.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve të MF sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet totale të fondeve sipas kategorive	**14,370,995**	**12,494,242**	**9,322,497**	**5,827,256**	**5,263,086**
Pagat dhe Mëditjet	2,555,790	2,911,640	2,782,453	2,497,902	2,546,677
Mallrat dhe Shërbimet	2,462,806	2,460,011	1,893,388	1,551,540	2,345,981
Shërbimet komunale	126,645	62,249	31,862	37,735	35,956
Subvencionet dhe Transferet	3,226,000	3,305,432	2,722,291	1,241,086	288,757
Investimet Kapitale	5,999,754	3,754,910	1,892,503	498,993	45,715

Duke ju referuar kësaj tabele, në vitin 2018, buxheti final i MF (pa DK dhe ATK) është shpenzuar 75% ose 9,322,498€, që është 13% më i lartë se vitin e kaluar. Për më tepër, dobësi evidente vërehen në planifikimin fillestar të buxhetit, dhe nëse krahasohen shpenzimet e buxhetit në fund të vitit me buxhetin fillestar, shihet se buxheti fillestar është realizuar vetëm 65%.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore, përfshirë arsyet dhe ndikimin që kanë pasur, janë paraqitur si në vijim:

- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje ishte 355,850€. Kjo ishte si rezultat i rritjes nga donacionet e jashtme në vlerë prej 511,465€ dhe zvogëlimit në fund të vitit me vendim të qeverisë në vlerë 155,410€. Shpenzimi i mjeteve tek kjo kategori ishte 96%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte shpenzuar vetëm 77%. Ndryshimi i buxhetit final në krahasim me buxhetin fillestar ishte si rezultat i zvogëlimit me transfere të brendshme brenda programeve të MF-së;
- Buxheti final për komunali ishte reduktuar për 64,396€ nga ai i planifikimeve fillestare. Përkundër reduktimeve, realizimi i buxhetit final te kjo kategori ishte vetëm 51%, përderisa të gjitha obligimet komunale ishin paguar. Arsyeja e këtyre ndryshimeve në buxhet ishte planifikimi i dobët, duke mos marrë parasysh shumat e shpenzuara në këtë kategori gjatë tri viteve të fundit;
- Kategoria e investimeve kapitale ka pësuar zvogëlim të buxhetit. Buxheti fillestar ishte 5,999,754€, ndërsa buxheti final ishte reduktuar për 2,244,844€. Këto shkurtime ishin bërë me vendim të qeverisë në tre mujorin e fundit të vitit, si pasojë e ngecjes dhe mosrealizimit të disa projekteve kapitale të MF-së, siç ishte projekti për ndërtimin e objektit për nevojat e Doganës dhe Administratës Tatimore. Më tej, tek buxheti final i MF-së prej 3,754,910€, janë të përfshira edhe mjetet për fondin e mirëbesimit për Komunat Veriore në vlerë prej

1,858,258€, të cilat nuk duhet të merren për bazë me rastin e krahasimit të buxhetit me realizimin, për arsye se nuk menaxhohen nga MF. Andaj, buxheti final investime kapitale për programet në menaxhim të MF-it ishte 1,896,652€, ndërsa realizimi është 1,892,503€ apo 99%.

- Në krahasim me buxhetin fillestar, buxhetit final për subvencione ishte rritur për 79,432€. Kjo rritje është e pakuptueshme, përderisa buxheti në fund të vitit kishte rezultuar me tepricë domethënëse prej 583,141€ apo ishte realizuar vetëm 82%.

Çështja B1[2] – Planifikim dhe performancë e dobët buxhetore

Gjetja

Fakti që buxheti fillestar rezulton me vetëm 65% të realizimit përfundimtar të buxhetit, shpalos dobësi dhe mungesë të analizave në planifikimin e buxhetit. Për vitin 2018, ekzekutimi i buxhetit ne kategorinë mallra dhe shërbime është në nivel 75% në raport me buxhetin final. Nëse përjashtojmë nga analiza krahasuese mjetet për fondin e mirëbesimit për Komunat Veriore dhe fondet e kontigjencës shtetërore, përqindja e realizimit arrin në 91%, mirëpo ende mbetet në nivel jo të kënaqshëm.

Një realizim i dobët vërehet sidomos në kategorinë mallra dhe shërbime 77% situatë po thuaj e ngjashme ishte edhe në vitin e kaluar. Shkallë e ulët e ekzekutimit vërehet edhe tek subvencionet dhe transferet me 82%.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mosrealizimit të disa projekteve tek mallrat dhe shërbimet, pasi që njësit e kërkesës nuk kanë proceduar me kohë kërkesat e tyre në zyrën e prokurimit për zhvillimin e këtyre aktiviteteve . Ndërsa, subvencionet dhe transferet nuk ishin shpenzuar për faktin se ky fond kryesisht përbëhet prej kontigjencës shtetërore e cila nuk menaxhohet nga MF. Kjo ka ndikuar negativisht në performancën e përgjithshme buxhetore.

Rreziku

Shpërputhjet në mes planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit ndikojnë në mbetjen e tepricave buxhetore, në njërën anë, dhe mosrealizimin e projekteve të parapara, në anën tjetër. Shfrytëzimi joefikas i burimeve në dispozicion rritë rrezikun për mos arritjen e objektivave të Ministrisë.

Rekomandimi B1

Ministri duhet të siguroj se me rastin e përgatitjes së buxhetit vjetor, janë kryer analiza të hollësishme, duke iu referuar edhe të dhënave historike të viteve të fundit. Gjithashtu, të bëhet analiza dhe prioritizimi i projekteve për të cilat ekzistojnë të gjitha parakushtet që të njëjtat të fillojnë me procesin e realizimit gjatë vitit. Veç kësaj, njësitë kërkuese duhet që me kohë të procedojnë kërkesat për realizmin e projekteve.

[2] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura

3.1.1 Të hyrat

MF, përfshirë DK dhe ATK për vitin 2018 ka realizuar 1,555,668,997€ të hyra neto. Ndërsa, vetëm MF ka realizuar 144,690€, të hyra që kanë të bëjnë me gjobat ndaj institucioneve financiare dhe të hyrat nga licencimi i aktiviteteve individuale dhe të lira.

Në tabelën vijuese janë paraqitur të hyrat totale të MF-së. Mirëpo, të hyrat nga DK dhe ATK nuk janë pjesë e këtij auditimi, pasi që ato trajtohen në raporte të veçanta.

Tabela 3. Të hyrat tatimore dhe jo tatimore dhe kthimet (në €)

Agjencitë/ Departamenti	Të hyrat bruto	Kthimet	Të hyrat 2018	Të hyrat 2017	Të hyrat 2016
Dogana	1,135,015,816	4,231,318	1,130,784,498	1,111,953,000	1,044,042,000
ATK	468,388,976	43,649,167	424,739,809	365,917,000	355,380,455
NJIF	0	0	0	20,000	12,000
Thesari	55,000	0	55,000	265,200	282,750
Administrata Qendrore	89,690	0	89,690	88,465	79,231
Totali	**1,603,549,482**	**47,880,485**	**1,555,668,997**	**1,478,243,665**	**1,399,796,436**

Në vitin 2018 të hyra totale në MF, DK dhe ATK janë 1,555,668,997€, krahasuar me vitin paraprak janë realizuar 77,425,332€ më shumë apo rreth 5%. Rritja kryesore është në të hyrat tatimore në ATK për 58,822,809€ apo 16% dhe ne Doganë ishte për 18,831,498€ apo 1.7%, ndërsa të hyrat nga MF, Thesar dhe NJIF ishin zvogëluar për 228,973€ në raport me vitin 2017.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MF. Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve për vitin 2018 ishte 2,911,640€, ndërsa është shpenzuar në masën prej 2,782,453€, apo 96% e buxhetit.

Ne testuam edhe menaxhimin e proceseve në aspektin e pajtueshmërisë sa i përket menaxhimit të aktiviteteve në fushën e personelit, dhe identifikuam këto çështje:

Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

Çështja B2 – Mos plotësimi i pozitave të lira

Gjetja

Sipas Ligjit Nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, Ministria kishte të aprovuara 333 pozita.

Aktualisht MF ka të plotësuara 318 pozita, ndërsa 15 pozita të tjera kanë mbetur të lira. Këto pozita kanë të bëjnë me:

- Departamenti i Buxhetit (4);
- Departamenti i Thesarit (3);
- Departamenti i Partneritetit Publiko Privat (3);
- Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (1);
- Njësia Qendrore Harmonizuese (1);
- Departamenti i Politikave Fiskale (1);
- Departamentit i Politikave Ekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar (1); dhe
- Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme (1).

Disa nga këto pozita, si: Drejtor i Departamentit të Politikave Ekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar dhe Udhëheqës Divizioni për Raportim Financiar, kanë mbetur të paplotësuara tashmë disa vite, përkundër faktit se janë pozita kyçe në strukturën organizative të MF-së. MF gjatë vitit disa herë kishte shpallur konkurse për mbulimin e këtyre pozitave të lira me zyrtar të rregullt.

Arsyet e mosplotësimit të këtyre pozitave kryesisht kanë të bëjnë me mungesën e kandidatëve të përgjegjshëm për pozitat e shpallura, ndërsa në disa raste mungonte iniciativa e menaxhmentit për shpalljen e konkurseve dhe plotësimin e pozitave të lira.

Rreziku

Mos plotësimi apo vonesat në plotësimin e pozitave të caktuara, rrisin rrezikun që aktivitetet operative dhe menaxhuese të MF të mos kryhen me profesionalizëm, me kohë, në mënyrë cilësore apo edhe të mos kryhen fare. E gjithë kjo mund të ndikoj në mos arritjen e objektivave të përcaktuara nga departamentet përkatëse.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura që të eliminohen arsyet apo pengesat e plotësimit të pozitave të lira, posaçërisht pozitave kyçe.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2018 ishte 2,460,011€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,893,388€, apo 77% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë kryesisht me mirëmbajtje të TI, furnizime për zyrë, shërbimet kontraktuese tjera, shpenzimet e qerasë si dhe mëditje për udhëtime zyrtare jashtë vendit.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere në MF ishte 3,305,432€. Pjesën më të madhe të buxhetit tek kjo kategori e përbën kontigjenca 3,000,0000€. Buxheti rritet gjatë vitit me ndryshimet buxhetore me vendim të kryeministrit, të cilat barten nga kodi organizativ i rezervës shtetërore tek programi i Thesarit, në subvencione dhe transfere, për ekzekutim. Prej këtyre mjeteve, në vitin 2018 ishin shpenzuar 2,722,291€, apo 82% e buxhetit. Ne kemi testuar 24 mostra në vlerë 2,577,463€ tek kjo kategori dhe në 22 pagesa të kësaj natyre, nuk kishte raporte kthyese për të arsyetuar qëllimin e shpenzimit.

Në ligjin e buxhetit, rezerva shtetërore është kod organizativ i veçantë, ndërsa MF/Thesari është vetëm në rolin e ekzekutuesit të pagesave nga ky buxhet, prandaj të gjitha çështjet që lidhen me këto shpenzime, më gjerësisht do t'i trajtojmë në raportin vjetor të auditimit për vitin 2018.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final vetëm për programet në menaxhim të MF ishte 1,896,652€ dhe prej tyre ishin shpenzuar 1,892,503€, apo 99% e buxhetit, shpenzimet apo projektet kanë të bëjnë me blerje të softuerit, pajisjeve të teknologjisë informative dhe kompjuterëve.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë shqyrtuar disa çështje të përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja B3 – Pranimi i faturës para zotimit të mjeteve dhe procedimit të urdhër blerjes

Gjetja Sipas rregullës së Thesarit nr. 01/2013 për shpenzimin e fondeve publike, fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procesohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Në 11 pagesa nga gjithsej 61 të testuara, zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të faturave. Vonesat në zotimin e këtyre pagesave ishin nga një deri në 33 ditë. Ndërsa, në gjashtë pagesa të tjera, urdhër blerja ishte bërë pas pranimit të faturës, me vonesë nga 2 deri në 23 ditë.

Kjo ishte si rezultat i mos koordinimit dhe mos bashkëpunimit ndërmjet menaxherit të kontratës dhe zyrtarit të prokurimit me zyrën e financave, në mënyrë që të gjitha pagesat të procedoheshin sipas rregullave.

Rreziku Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme, rritë rrezikun e krijimit të vonesave në realizmin e pagesave me kohë, rrjedhimisht rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues. Derisa, pranimi i mallrave dhe shërbimeve para se të përcaktohen kërkesat/nevojat, mund të rezultojë me mos pranimin e mallrave/shërbimeve sipas nevojës dhe cilësisë së duhur.

Rekomandimi B3 Ministri duhet të siguroj bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet të gjitha palëve pjesëmarrëse në proces, që nga bërja e porosive deri të aktivitetet e kontrollit rreth realizmit të pagesave, në mënyrë që ato të procedohen sipas rregullave në fuqi.

Çështja B4 - Dobësi në vlerësimin e ofertave-dhënia e kontratës OE pa i plotësuar kriteret

Gjetja Sipas nenit 59.4 të LPP-së, autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Nga 12 mostrat e testuara tek mallrat/shërbimet dhe investimet kapitale për qëllime pajtueshmërie me legjislacionin, ne kemi gjetur se në një rast, komisioni i vlerësimit të ofertave kishte vlerësuar si të përgjegjshëm dhe kishte rekomanduar nënshkrimin e kontratës me operatorin i cili nuk i kishte plotësuar kriteret e përcaktuara me dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë:

Autoriteti kontraktues (AQP) kishte zhvilluar procedurën e prokurimit "Shërbimet e përkthimit për nevojat e Akademisë së Drejtësisë Ri-tender", në vlerë 38,589€. Tek kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit lidhur me mundësitë teknike-profesionale, kërkohej si dëshmi lista e stafit profesional së bashku me diplomat/çertifikatat, cv-të dhe kopjet e kontratave të punës. OE për përkthyesit nga gjuha shqipe – serbe dhe anasjelltas, nuk kishte ofruar diplomë/çertifikatë, siç ishte kërkuar me dosjen e tenderit, mirëpo si dëshmi kishte bashkangjitur aktvendimet e gjykatës për caktimin e tyre si përkthyes.

Kjo kishte ndodhur për shkak se komisioni i vlerësimit nuk kishte marrë parasysh dhe kishte neglizhuar kriteret e përcaktuara me dosjen e tenderit, mirëpo vlerësimin e kishte drejtuar në aspektin e mundësisë teknike dhe funksionale që stafi t'i përmbushë objektivat e projektit.

Rreziku Anashkalimi i kritereve të dosjes së tenderit rezulton me shpërblimin e OE fitues të pa përgjegjshëm, duke ndikuar kështu në zvogëlimin e besueshmërisë së procesit. E gjithë kjo, rrezikon cilësinë e shërbimeve dhe arritjen e objektivave të parapara me projekt.

Rekomandimi B4 Ministri duhet të sigurojë bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet komisioneve të vlerësimit dhe zyrëtarëve të prokurimit, me qëllim të ngritjes së përgjegjësisë tek komisionet, në mënyrë që vlerësimet të bëhen duke u bazuar në kriteret e vendosura në dosje të tenderit, dhe jo në bazë të kapaciteteve profesionale e teknike të OE-ve për të kryer punë.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera neto e pasurisë kapitale mbi 1,000€ në regjistrin kontabël të MF-së ishte 2,156,390€, ndërsa vlera neto e pasurive jo kapitale nën 1,000€ ishte 171,270€. Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore.

Menaxhimi i pasurisë në MF bëhet i pavarur në katër njësitë e saj, Administratën Qendrore, Thesar, Agjencinë Qendrore e Prokurimit (AQP) dhe Njësinë e Inteligjencës Financiare (NjIF).

Çështja A1 – Dobësi në procesin e inventarizimit të pasurisë

Gjetja Sipas Rregullores MF nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 19, pika 4, përkatësisht 4.7, ndër përgjegjësitë e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e pasurisë jo financiare në kohën e përshtatshme, para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore.

Megjithëse, në tri njësitë e MF-së, përveç NJIF, ishte formuar komisioni për inventarizimin e pasurive në fund të vitit, i njëjti nuk kishte përfunduar punën me kohë dhe mungonte harmonizimi i të dhënave nga raporti i inventarizimit me evidencat e zyrtarit të pasurisë.

Kjo kishte ndodhur pasi që komisioni i inventarizimit kishte neglizhuar afatet kohore të përcaktuara me rregulloren përkatëse për përfundimin me kohë të raportit të përgjithshëm të inventarizimit.

Rreziku Mos azhurnimi i regjistrit të pasurisë dhe mos harmonizimi i gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrin kontabël rrisin rrezikun që pasuritë të keqpërdorën, humben apo të tjetërsohen, si dhe vlera e pasurisë së organizatës e pasqyruar në PFV të mos jetë e drejtë.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të siguroj bashkëpunim të ngushtë ndërmjet zyrtarit të pasurisë dhe komisionit, për përfundimin e raportit të inventarizimit në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, në mënyrë që të pasqyrohet gjendja e saktë e pasurisë.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 12,089€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Ne testuam raportet mujore të obligimeve, fatura të obligimeve të prezantuara në PFV, si dhe librin e furnitorëve për dy mujorin e vitit 2019. Testet tona në këtë kategori shpalosen se menaxhimi dhe raportimi i obligimeve është bërë në pajtueshmëri me legjislacionin.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

MF pasqyron një situatë pozitive në fushën e llogaridhënies, menaxhimit të rrezikut dhe cilësisë së raportimit menaxherial. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit ka përpjekje për përmirësim, mirëpo adresimi i plotë ende mbetet sfidë për ministrinë. Komiteti i auditimit (KA) nuk kishte funksionuar gjatë gjithë vitit 2018, për t'i dhënë një shtytje më të madhe zbatimit të rekomandimeve. MF edhe këtë vit kishte përmbushë kërkesën lidhur me dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit.

Ministria posedon strategjinë gjithëpërfshirëse të zhvillimit të institucionit për vitet 2017-2019, planin vjetor bazuar në këtë strategji, si dhe planin për menaxhimin e rrezikut i cili azhurnohet në baza gjashtë mujore.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

MF ka një sistem funksional të auditimit të brendshëm që përbën një segment të rëndësishëm të kontrolleve në përgjithësi. Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) përbëhet nga drejtori dhe shtatë zyrtarë. Është e organizuar në dy divizione: në atë për auditime në MF si dhe Divizioni për auditime jashtë MF-së, në entitete që nuk kanë të themeluara Njësinë e AB-së.

NJAB për vitin 2018 ka planifikuar të kryej 16 auditime të rregullta, tetë auditime brenda MF-së, tetë auditime tjera jashtë MF-së dhe dy të tjera sipas kërkesës/ad-hoc. Të gjitha auditimet e planifikuara ishin realizuar, përfshirë edhe dy auditimet shtesë, duke dhënë rekomandime konkrete për përmirësimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit.

Çështja A2 – Mosfunksionimi i KA gjatë gjithë vitit

Gjetja Komiteti i Auditimit nuk kishte funksionuar gjatë tërë vitit 2018, siç kërkohet me Ligjin nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, neni 20 për themelimin e KA. Komitetit të auditimit i kishte skaduar mandati në korrik të vitit 2018 dhe në muajin dhjetor ishte themeluar komitetit i ri i auditimit. Gjatë vitit 2018, Komiteti i auditimit kishte arritur të mbajë vetëm dy mbledhje (nga një secila përbërje).

Sipas MF-së, vonesa në themelimin e KA të ri kishte ndodhur për shkak se në kohën kur duhej të formohej KA i ri, kishin ndryshuar kërkesat ligjore në lidhje me themelimin e KA-ve, duke qenë kërkesa më sfiduese, gjë që ministrinë e ka sjellë në vështirësi për të zgjedhur anëtarët e ri të KA-së.

Rreziku Mosfunksionimi i plotë i KA mund të rrezikojë cilësinë e punës së NJAB dhe rrjedhimisht sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me efektivitetin e kontrolleve kyçe financiare, me ndikim edhe në nxitjen e menaxhmentit për të zbatuar rekomandimet e auditimit.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të stimuloj dhe mbështesë punën e KA, në mënyrë që të sigurohet se roli dhe misioni i KA në ministri po përmbushet dhe funksioni i auditimit të brendshëm është i monitoruar mirë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëj me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti i MF ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Në kuadër të MF-së funksionojnë agjencitë ekzekutive, si: Dogana e Kosovës (DK), Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) dhe Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF).

Agjencitë ekzekutive përgatisin pasqyra financiare, të cilat konsolidohen në PFV-të e MF-së. Agjencitë kanë strukturën e vet menaxheriale, përmes të cilës organizohet menaxhimi i aktiviteteve të përditshme operative. Menaxhimi dhe funksionimi i të gjitha aktiviteteve në DK dhe në ATK do të trajtohen në raporte individuale të auditimit të kryera nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Ndonëse menaxhmenti ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, MF edhe më tutje duhet t'i kushtojë rëndësi më të madhe përqindjes së realizmit të buxhetit, proceseve dhe zhvillimeve në fushën e prokurimit, personelit dhe menaxhimit pasurisë.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të MF ka rezultuar në 10 rekomandime kryesore. MF kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit për vitin 2018, pesë rekomandime janë zbatuar; një ishte mbyllur dhe katër nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 4 (Tabelën e rekomandimeve).

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të bëj një analizë dhe të identifikoj arsyet për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit për mallra dhe shërbime dhe komunali, duke përcaktuar opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij para përcaktimit të programeve për vitet në vijim.	MF nuk kishte ndërmarrë veprime për këtë çështje, pasi që e njëjta gjetje është përsëritur edhe këtë vit.	Rekomandimi i pa zbatuar.
2	Te hyrat	Ministri duhet të siguroj kontrolle të mira në harmonizimin e të hyrave, të identifikohen shkaqet për mungesë të harmonizimit të rregullt-mujor ndërmjet shënimeve të MF-it me të hyrat e regjistruara në SIMFK, dhe të merren veprimet adekuate/përmirësuese.	MF në vitin 2018 ka filluar harmonizimin mujor të të hyrave	Rekomandim i zbatuar
3	Paga dhe mëditje	Ministri duhet të sigurojë kontrolle adekuate në menaxhimin e procesit të pagave dhe orëve shtesë për personelin e Ministrisë. Pagesat të bëhen në përputhje më pozitat/koeficientet si dhe rregullat e aprovuara.	MF në vitin 2018 ka harmonizuar koeficientet e këtyre zyrtarëve me akt emërimet. Po ashtu, nga mostrat e testuara për punën jashtë orarit, kemi parë se puna jashtë orarit ka filluar të menaxhoh	Rekomandim i zbatuar

			et sipas rregullave	
4	Paga dhe mëditje	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore që të gjitha pozitat në Ministri të jenë të rregullta dhe në pajtueshmëri më strukturën organizative dhe rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës.	MF ende nuk ka plotësuar me staf këto pozita.	Rekomandimi i pa zbatuar
5	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të sigurojë që kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar më LMFPP-në, dhe më rregullat e Thesarit 01/2013 për shpenzimin e paras publike.	MF nuk kishte ndërmarrë veprime për këtë çështje, pasi që edhe këtë vit nga mostrat e testuara kanë rezultuar raste te tilla.	Rekomandimi i pa zbatuar
6	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj kontrolle të mira dhe menaxhim adekuat të proceseve të prokurimit. Komisionet për vlerësimin e ofertave të mbikëqyren si duhet në mënyrë që të zbatohen ligjet, rregullat dhe të promovohet transparenca e konkurrenca me rastin e vlerësimit të ofertave	MF nuk kishte ndërmarrë veprime për këtë çështje, pasi që edhe këtë vit nga mostrat e testuara kanë rezultuar raste te tilla.	Rekomandimi i pa zbatuar
7	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Ministri duhet të ndërmerr veprime për forcimin e kontrolleve në mënyrë që pas shpalljes së fituesit të kontratës dhe kalimit të afateve të ankimimeve, kontratat të nënshkruhen, me kohë/pa vonesa.	MF kishte ndërmarrë veprime sa i përket këtij rekomandime, pasi që nga mostrat e testuara në këtë vit	Rekomandimi i zbatuar

			nuk kanë rezultuar raste të tilla.	
8	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj kontrolle adekuate në këtë fushë, të siguroj raportim cilësorë dhe bashkëpunim me Avokaturën Shtetëror me qëllim të përfaqësimit adekuat të institucionit në gjykata.	MF në PFV-të 2018 kishte shpalosur detyrimet kontigjente.	Rekomandim i zbatuar.
9	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Ministri duhet të siguroj që është zbatuar plani i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga AP, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.	MF kishte ndërmarrë disa veprime në implementimin e disa nga rekomandimeve të vitit 2017, mirëpo, plani i veprimit nuk ishte zbatuar në tërësi.	Rekomandim i mbyllur
10	Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri se bashku me Komitetin e Auditimit, duhet të sigurojnë se plani i NJAB mbështetet në masë të konsiderueshme në fushëveprimin e vitit aktual. Një qasje pro aktive do të rritë përfitimet nga NJAB dhe do të mundësoj që parregullsitë/devijimet e mundshme në sistemet e kontrollit të adresohen në kohën e duhur.	Nga shqyrtimi i raporteve të NJAB për vitin 2018, kemi parë se shumica e tyre mbulonte fushëveprimin e vitit aktual.	Rekomandim i zbatuar.

Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Rekomandimi B1 Ministri duhet të identifikoj arsyet për mosrealizimin e aktiviteteve tenderuese tek mallrat dhe shërbimet dhe planifikimin jo të mirë tek shërbimet komunale ndër vite, duke përcaktuar opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij para përcaktimit të programeve për vitet në vijim.
2	Paga dhe mëditje	Rekomandimi B2 Ministri duhet të shqyrtoje shkaqet e mungesës së kandidateve të përgjegjshëm dhe të ndërmarrë veprime konform tyre, në mënyrë që të eliminohen pengesat e plotësimit të pozitave të lira, posaçërisht pozitave kyçe.
3	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Rekomndimi B3 Ministri duhet të sigurojë bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet të gjitha palëve pjesëmarrëse në zinxhirin e kontrollit të pagesave, në mënyrë që ato të procedohen sipas rregullave në fuqi.
4	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Rekomndimi B4 Ministri duhet të sigurojë bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet komisioneve të vlerësimit dhe zyrës së prokurimit, me qëllim ngritjen e vetëdijes tek komisionet, në mënyrë që vlerësimet të bëhen duke u bazuar në kriteret e vendosura dhe jo në bazë të kapaciteteve profesionale e teknike të OE-ve për të kryer punë.
5	Pasuri kapitale dhe jo kapitale	Rekomndimi A1 Ministri duhet të sigurojë bashkëpunim të ngushtë ndërmjet zyrtarit të pasurisë dhe komisionit, për përfundimin e raportit të inventarizimit në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, në mënyrë që në PFV të pasqyrohet gjendja e saktë e pasurisë.
6	Sistemi i auditimit të brendshëm	Rekomndimi A2 Ministri duhet të siguroj mbajtjen e mbledhjeve të nevojshme dhe aktivitete të mjaftueshme të KA, në mënyrë që të sigurohet se roli dhe misioni i KA në ministri po përmbushet.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmimi

Shtojca II: Komentet e MF-së në gjetjet e raportit të auditimit

Të gjeturat / Çështjet	**Pajtohemi po/jo**	**Komentet e Ministrisë së Financave në rast të mospajtimit**	**Pikëpamja e ZKA-së**
Çështja B1[2]: Planifikim dhe performancë e dobët buxhetore (Rek.B1)	Po	Sa i përket planifikimit të buxhetit në MF, kemi një planifikim efikas por duke pas parasysh vendimet e Qeverisë për buxhetimin e kontigjencave dhe Fondit Zhvillimor të Mirëbesimit, na del se kemi performancë jo të mirë në realizim të buxhetit.	
Çështja B2: Mos plotësimi i pozitave të lira (Rek.B1)	Po	Ky rekomandim ka filluar të zbatohet: Është zgjedhur drejtori i Dep.të Makroekonomisë, pas shumë konkurseve të publikuara dhe udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit, ndërkohë që jemi në procesin e rekrutimit për pozitën udhëheqës i Divizionit për Raportim Financiar dhe me radhë për të gjitha pozitat e lira të planifikuara me buxhet.	
Çështja B3: Pranimi i faturës para zotimit të mjeteve dhe procedimit të urdhër blerjes (Rek.B2)	Po	Ky rekomandim, ka filluar të zbatohet gjatë fazës së Auditimit.	
Çështja B4: Dobësi në vlerësimin e ofertave-dhënia e kontratës OE-ve pa i plotësuar kriteret (Rek.B3)	Po		
Çështja A2: Dobësi në procesin e inventarizimit të pasurisë (Rek.A2)	Po	Kjo e gjetur pranohet dhe do të gjen zbatim në vitin fiskal 2019. Megjithatë theksojmë se procesi i inventarizimit të pasurisë nuk ka pas ndikim negativ në Raportin final të pasqyrave financiare.	
Çështja A3: Mosfunksionimi i KA gjatë gjithë vitit (Rek. A3)	Po	Ky rekomandim është zbatuar pasi MF ka formuar KA gjatë vitit 2018	

Me respekt,
Naim Baftiu
Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Financave